



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 10

Datë: 09. 02. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Rifat Krasniq, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Valmira Selmani, drejtoreshë, ud e ZRPP.

Përkthyese: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr.1,6 dhe 8/2022:
3. Aktivitetet e SKQZ:
4. Aktivitetet e ZRPPC:
 - Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrim të partisë politike “GUXO” (GUXO).
 - Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrim të partisë politike “Bashkimi për Ndryshim ANAMORAVA” BNA.
5. Raport i Këshillave të KQZ-së:
 - Këshilli për Çështje Ligjore..
 - Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal, në Istog.

- Këshilli për Buxhet dhe Financa:
 - Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimeve për zgjedhjet lokale 2021.
 - Këshilli për Marrëdhëniet me Jashtë:
 - Ftesa për KQZ-në për vëzhgimin e zgjedhjeve në Slloveni, 24 prill 2022.
 - Komiteti i Auditimit:
 - Njoftim nga Komiteti i Auditimit.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të panelit interviewues për pozitën zv. Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së dhe Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC-së.
7. Të ndryshme.
-

1. **Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:** Pas hapjes së mbledhjes, kryetari i KQZ-së iu referua edhe ardhjes së anëtarit të ri të KQZ-së Sami Hamiti dhe futjes në rend dite të çështjes së plotësimit të këshillave të KQZ-së, në vend të ish anëtarit F. Dushi. A ka dikush diçka tjetër ? Procesverbali nr. 1 u hoq, atëherë kush është për...?

Në vazhdim, u miratua rendi i ditës me vota unanime. Po ashtu, edhe procesverbalet nr. 6 dhe 8/2022 nga mbledhjet e KQZ-së, me një votë abstenimi (S. Hamiti).

2. **Aktivitetet e SKQZ:**

Burim Ahmetaj: Sekretariati, ua ka dërguar një raport mbi aktivitetet tona, ndër ma kryesoret. E para, aktivisht jemi marrë me ndryshim - plotësimin e rregullave zgjedhore, një aktivitet yni që është në planin e punës së KQZ-së për vitin 2022, i cili parashihet të realizohet nga muaji shkurt deri në muajin prill. Bazuar në vendimin e KE-së të datës 23.02.2022, nr.343/2022, është formuar grupi punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullave Zgjedhore. Takimi i pare, është zhvilluar me datën 02.03.2022 dhe nga ajo kohë, Sekretariati intensivisht është duke punuar në baza ditore për përgatitjen e drafteve për plotësimin ndryshimin e rregullave. Gjatë këtij procesi është identifikuar nevoja për draftimin e një rregulle të re e cila, do të rregullojë procesin e “Transmetimit dhe të publikimit te rezultateve preliminare”, dhe për ketë është krijuar një komision për draftimin e kësaj rregulle. Deri me tani, janë trajtuar rregullat si më poshtë: 1.Rregulla Zgjedhore Nr.01/2013 për Regjistrimin dhe veprimin e Partive Politike. 2. Rregulla

Zgjedhore Nr.08/2013 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre. 3. Rregulla Zgjedhore Nr. 01/2020 për Fletëvotime dhe Broshura. 4. Rregullën Zgjedhore Nr.08/2013 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre. 5. Rregullën Zgjedhore Nr. 07/2013 Vëzhguesit e Zgjedhjeve. 6. Rregulla Zgjedhore Nr.12/2013 Kufizimi i Shpenzimeve të Fushatës dhe Deklarimi Financiar. 7. Rregulla Zgjedhore Nr 14/2013 Financimi i Subjekteve Politike dhe Sanksionet.

Me rregullat tjera, do të vazhdojmë të merremi në ditët në vijim. Gjithashtu, sekretariati nga muaji janar 2022, ka filluar me draftimin e raportit vjetor të punës së KQZ për vitin 2021, i cili duhet të dorëzohen në Kuvendin e Kosovës, më së largu deri me 30 prill 2022. Raporti është në fazën e draftimit dhe drafti i parë, është paraparë të jetë gati në fillim të muajit prill 2022. Raporti përfshin Planin e Punës së KQZ-së për vitin 2021 dhe aktivitetet e rregullta si dhe dy (2) procese zgjedhore që pasqyron procesin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës që janë mbajtur me 14 shkurt 2021 dhe zgjedhjet lokale që janë mbajtur me 17 tetot 2021.

S'i aktivitet tjetër, kemi ndarë edhe asgjësimin e materialeve zgjedhore të Zgjedhjeve Lokale, 2021. Ky aktivitet, tha z. Ahmetaj, është në procesin e kompletimit të procedurave për zhvillimin e aktivitetit të prokurimit për asgjësimin e materialit zgjedhor. Sekretariati, në këtë aspekt, ka marrë listën nga PZAP dhe Prokuroria e Shtetit, të materialeve nga vendvotimet që duhet të ruhen për shkak se mund të jenë objekt i hetimit për zgjedhjet lokale 2021, dhe tashmë Sekretariati është edhe në një proces tjetër duke analizuar dhe identifikuar të gjitha vendvotimet që kanë dallime në vota, para dhe pas rinumërimit, për të përgatitur raportin dhe të prezantojë në KQZ së bashku me rekomandime për ruajtjen e materialeve për shkak të dallimeve në vota para dhe pas rinumërimit.

Pas këtij procesi dhe kompletimit të procedurave të prokurimit, do të mund të fillojë procesi i asgjësimit të materialeve. Sipas planit të punës së KQZ-së, parashohim që ky aktivitet të realizohet nga muajt shkurt, mars, dhe prill 2022.

Ju njoftojmë po ashtu se, pas problemeve në ueb faqen e KQZ-së të paraqitura me datë 14 shkurt, ku është paraqitur virusi ‘malware’ në ueb faqe dhe janë ndërmarr veprimet për identifikimin dhe pastrimin e fajllave te infektuar me malware.

Në vazhdim, z. Ahmetaj tha se me datë 17.02.2022, është bërë instalimi i një serveri në një mjedis të jashtëm, është importuar databaza dhe fajllat e wordpressit të cilët janë konfiguruar dhe kontrolluar për fajllat e infektuar. Është regjistruar subdomaini ‘eeb1.kqz-ks.org’ ku është regjistruar webfaqja. Trafiku nga domaini ‘kqz-ks.org’, është

ridrejtuar përkohësisht në subdomainin ‘‘ëeb1.kqz-ks.org’’. Janë eliminuar të gjitha problemet teknike dhe ueb faqja, tani është funksionale.

Një çështje tjeter, sipas krye shefit Ahmetaj, lidhet me zyrat e KKZ-ve nëpër komuna që pothuajse shumica e tyre përkrahën nga komunat duke ofruar zyre në objektet e komunave si dhe ofrimin e përkrahjes logjistike. Por, kohë pas kohe na shfaqen probleme në këtë drejtim, ku e ka përmendur komunën e Podujevës, në të cilën zyra e ZLKZ-së është vendosur në objektin kryesor të Administratës së Komunës. Kemi marrë një shkresë nga Drejtoria e Administratës, për lirimin e asaj zyre dhe akomdimin në objektin tjeter të Komunës (objekti i vjetër i Komunës) që ndodhet në afërsi të objektit të ri të Komunës së Podujevës, ka raportuar z. Ahmetaj. Arsyja është se, ajo zyre i nevojitet komunës për nevoja të tyre dhe stafit.

Edhe pas komunikimeve dhe kontakteve me përgjegjësit në këtë komunë, për momentin jemi pa zyrë të KKZ-ë në Podujevë, dhe se në një të ardhme të afërt, siç na është premtuar, do të mundësohet për KKZ-në në Podujevë nga administrata e Komunës, zhvendosja e materialeve dhe pajisjeve te KKZ-se në zyrën një (1) dhe në zyrën dy (2) e cila do të shërbejë si depo për KKZ në objektin tjeter të Komunës së Podujevës.

Ndër aktivitetet e tjera, u tha se është aktiviteti: “Forcimi i komunikimit ndërmjet Zyrtarëve Komunal të Zgjedhjeve dhe Sekretariatit të KQZ-së” që përkrahet nga OSBE dhe për ketë do të realizohen katër (4) punëtori. Po ashtu, kilpi i Zgjedhjeve të OSBE - së, do të ndihmojë KQZ-në në rritjen e komunikimit të tyre të brendshëm ndërmjet niveleve të ndryshme të Sekretariatit. Në kuadër të këtij aktiviteti, Misioni do të mbështesë organizimin e katër (4) punëtorive gjatë vitit 2022 (mars, maj, tetor dhe nëntor). Punëtoritë do të shërbejnë gjithashtu si një vend për të diskutuar zbatimin e planit të punës dhe planifikimin e aktiviteteve për vitin 2023. Përveç kësaj, këto takime do të dizajnohen për të adresuar rekomandimet e MVZ-së të BE-së lidhur me këtë fushë. Secili prej këtyre takimeve do të përfshijë 50 pjesëmarrës, duke përfshirë zyrtarët komunalë të zgjedhjeve, zyrtarët e Sekretariatit të KQZ-së dhe anëtarët e ekipit të zgjedhjeve të OSBE-se. Në koordinimi me OSBE-në, punëtoria e parë është planifikuar të mbahet me datë 22 mars 2022, ndërsa lokacioni nuk është përcaktuar akoma.

Gjithashtu, z. Ahmetaj tha se Komisioni për Analizimin e Librave të Votimit me qëllim të hartimit të raportit “Analizë e votave me asistencë për Zgjedhjet Lokale, 17.10.2021”, ka nxjerrë të dhënat nga librat e votimit, të cilat në formatin e skanuar janë marrë në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Në zgjedhjet lokale të datës 17 tetor 2021, gjithsejtë kanë qenë 2,477 vendvotime (që i bie 2,477 libra të votimit). Nga 2,477 libra të votimit, komisioni ka bërë nxjerrjen e numrit të votave me asistencë (si hap i parë) për

gjithsejtë: 2,271 vendvotime. Pra, nuk kemi mund t'i nxjerrim të dhënat për 206 vendvotime, për shkak se këto libra, nuk janë të skanuara të dhënat janë nxjerrë vetëm për 91.68% të vendvotimeve. Ndërsa, në analizat e kaluara lidhur me votimin me asistencë (të zgjedhjeve parlamentare 2019 dhe zgjedhjeve lokale 2017) ne kemi nxjerrë të dhënat për rreth 98 – 99 % të vendvotimeve. Pjes 1% n tjetër të Librave të Votimit, do të sigurohen në ditët në vazhdim. Aktiviteti është në proces dhe siç mund të shihet, mungesa e librave të votimit në formatin e skanuar në “pdf” është zvogëluar, në 206 libra të votimit të mbetur. Ndërsa, përpjekja e komisionit do të jetë, që numri i librave të votimit që mungojnë të jetë sa më i vogël në fund. Sa për të ju njoftuar, numri i votave me asistencë (deri më tanj) për 2,271 vendvotime, është: 42,856 vota me asistencë. Pas datës 11 mars 2022, Komisioni do të angazhohet si grup, për t'i gjetur fizikisht librat e votimit që mungojnë, e të cilat mund të janë brenda hapësirës së QNR - së. Raporti parashihet të përfundojnë në muajin qershor 2022, ka thënë në fund z. Ahmetaj.

Sami Kurteshi, pyeti se, zyrat e KQZ-së që janë në qendra të ndryshme nga vizitat që i kemi bërë, ka zyre që funksionojnë por nuk janë në institucione shtetërore. A do të ndërmerret diçka që, këto zyrat tona të vendosen në institucionet shtetërore ? Dhe, sa I përket personave me të meta, edhe unë jam i interesuar që atyre, tu sigurohen gjithnjë e më shumë kushte të përshtatshme, pra të vendosen në katin e parë siç, e thatë...Po, të gjithë është mirë të angazhohemi..

Arianit Elshani: Në raport, ju folët rreth rregullave zgjedhore dhe ato, të trajtohen edhe në këshillin për çështje ligjore. Mirëpo, desha të di se a janë bërë përgatitjet që në muajin e katërt, të zhvillohet edhe një takim koordinues që, të përfshihemi të gjithë dhe ti shohim e trajtojmë nga afër ndryshimet e rregullave...

Ilir Gashi, tha se, sa u përket zyrave ka ardhur koha që të vëmë kontakt me kryetar të komunave për faktin se jemi në një vit zgjedhorë, dhe çfarë kemi parë në terren, ata nuk kanë kushte të mira për një proces zgjedhorë; Ne, duhet siguruar kushtet teknike dhe logjistike, dhe sidomos që të mos paguajmë për zyrat; Ndoshta, do ishte mirë të kemi një memorandum bashkëpunimi me kryetarët e komunave në këtë drejtim; Sa u përket rregullave, kur ju ti përfundoni mendoj që një nga një të vijnë në këshill për çështje ligjore, dhe pastaj t'i trajtojmë në fund të gjitha bashkërisht..

Rifat Krasniq: Ka raste kur një drejtues i zyrës, asnjëherë nuk vjen në zyrë. Pra, ku është faji kur një zyrtar nuk shkon në punë, nuk vjen në zyre...? Për shembull, zyrtari i KKZ-së në Mamushë jeton në Prishtinë, dhe nuk vjen asnjëherë në zyre, as kur ishte para pensionit dhe as tash që angazhohet përsëri pavarësisht se ka dalë në pension...

Lidhur me këto analiza, pyetje dhe interesime të tjera të anëtarëve të KQZ-së, dha përgjigjet krye shefi, Ahmetaj.

Alim Rama, pyeti rreth asaj se pse ka problem KKZ në Podujevë, dhe ajo që tha kolegu në Mamushë, por edhe në komunat e tjera. A dalin rregullisht në punë zyrtarët tanë...?

Rreth rastit në Podujevë, z. Ahmetaj tha se jemi në bashkëpunim ne komunën që ta zgjidhim këtë çështje, kurse në Mamushë ai tha se, nuk kemi raport për vijueshmërinë e tij. Mbështetje, nuk kemi bërë raporte lidhur me gjendjen e punës së tyre, por ata marrin pjesë në aktivitetet tona. Si do qoftë, do të jemi më aktiv në këtë drejtim...

3. Aktivitetet e ZRPPC:

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrim të partisë politike “Guxo”:

Valmira Selmani, u.d, e ZRPP: Zyra jonë, më 14 shkurt ka pranuar aplikacionin e një subjekti të ri politik, me emrin “Guxo”. Drejtuese e kësaj iniciative, është znj. Donika Gërvalla e cila, e ka dorëzuar aplikacionit konform rregullave dhe legjislacionit në fuqi. Dokumentacioni, është i kompletuar. Ne, kemi shqyrtuar çdo gjë, dhe rekomandojmë për regjistrim, dhe nëse ky rekomandim kalon ky subjekt regjistrohet në “Regjistrin e Partive Politike” me nr. 50.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për këtë rekomandim ?

Me 11 vota për, regjistrohet partia e re politike “Guxo”.

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrim të partisë politike “Bashkimi për Ndryshim ANAMORAVA” BNA:

Valmira Selmani, u.d, e ZRPP: Zyra jonë, ka pasur edhe një kërkesë të një iniciativë politike që ka ardhur më 18 shkurt me akronimin “Bashkimi për Ndryshim

ANAMORAVA” BNA. Kryesues i këtij subjekti, është z. Isa Agushi. Konform rregullave dhe legjislacionit në fuqi, është dorëzuar u gjithë dokumentacioni i nevojshëm, pra i kompletuar. Ne, kemi shqyrtuar çdo gjë të nevojshme sipas rregullave dhe ligjit, dhe zyra rekomandon për regjistrim, dhe nëse ky rekomandim kalon ky subjekt regjistrohet në “Regjistrin e Partive Politike” me nr. 51.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për këtë rekomandim ?

Me 11 vota për, regjistrohet edhe kjo partia e re me emrin: “Bashkimi për Ndryshim ANAMORAVA” BNA.

Faleminderit, dhe para se të kalojmë të këshillat, a pajtoheni që anëtarë i ri i KQZ-së, z. Sami Hamiti të jetë pjesë e këshillave në të gjitha vendet ku ka qenë z. Florian Dushi ?

Arianit Elshani: Po besoj se, veç këtij ndryshimi – plotësimi ne, duhet të ulemi serish, e ndoshta ta formojmë edhe një këshill të ri të informimit publik. Unë, mendoj se ka vend për kritikë në informimin dhe publikimin e materialeve në publik...

Kreshnik Radoniqi: Me 11 vota për, z. Sami Hamiti, është pjesë e këshillave në ato këshilla ku ka qenë z. Florian Dushi.

4. Raport i Këshillave të KQZ-së

1.Këshilli për Cështje Ligjore:

Sami Kurteshi: Ne, e kemi mbajtur mbledhjen e këshillit sot dhe, kishim një kërkesë: zëvendësimi i anëtarit të Kuvendit Komunal në komunën e Istogut. Ne, në bashkëpunim me zyrën, lidhur me kushtet që duhet plotësuar dhe si këshill ka miratuar dhe rekomandon KQZ-në për miratimin e tyre:

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Istogut, i dorëhequri Zenel Shatri zëvendësohet nga Haki Podrimja nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Me 10 vota për, miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Istogut, i dorëhequri Abedin Kabashi zëvendësohet nga Ruzhdi Metaj nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Me 10 vota për, miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Istogut, i dorëhequri Naim Behlulaj zëvendësohet nga Faik Alushaj nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Me 10 vota për, miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Istogut, i dorëhequri Agon Dreshaj zëvendësohet nga Veton Kurti nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Me 10 vota për, miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Istogut, e dorëhequra Merita Muzlijaj zëvendësohet nga Njomëza Demaj nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Me 10 vota për, miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Istogut, i dorëhequri Ali Nimanaj zëvendësohet nga Visar Haxhijaj nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Me 10 vota për, miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Istogut, i dorëhequri Arben Kabashi zëvendësohet nga Andi Gjuraj nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Me 10 vota për, miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Istogut, e dorëhequra Eliane Blakaj zëvendësohet nga Era Visoqi nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Me 10 vota për, miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Istogut, i dorëhequri Rasim Mahmutoviq zëvendësohet nga Melis Smakiq nga subjekti politik GIBI. Kush është për...?

Me 10 vota për, miratohet...

2.Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimeve për zgjedhjet lokale 2021:

Gordana Llaban: Në takimin e buxhetit kemi shqyrtuar shpenzimet nga zgjedhjet lokale 2021, dhe anëtarët e këshillit kanë shqyrtuar dhe kërkuar që raporti të plotësohet. Nga informacionet dhe të dhënrat, raporti i këtyre dy zgjedhjeve është: 7, 820 4957 euro. Megjithatë, të gjitha këto mjete nuk janë shpenzuar, mirëpo nga raporti del se janë shpenzuar: 6, 467 352 euro. Znj. Laban tha se më së shumti janë shpenzuar mjete në mallra dhe shërbime, në trupat zgjedhorë, K-vote, dhe personat e tjerë që kanë punuar. Nëse e llogarisim në tërësi, shpenzimet për një votues na kanë kushtuar 4.1 euro.

Ne, e kemi miratuar raportin në këshill dhe, rekomadnojmë ta votoni.

Në këtë pikë, diskutuan: **Sami Hamiti**, i cili tha se duke e analizuar raportin, janë disa vërejtje që, duhet marrë para sysh. Janë, disa mjete suficit dhe qeveria i merr; Pas përfundimit të vitit fiskal, mjetet e mbeturë alokohen diku tjetër...Ka gabime në shifra... Në përgjithësi, janë ulur shpenzimet krahasuar me zgjedhjet 2017 dhe, menaxhimi është bërë më i mirë...Në zgjedhjet e ardhshme, mund të planifikohet edhe më saktësisht... Por letë dihet, janë 5 milion që i shpenzojnë trupat zgjedhore...

Arianit Elshani, tha se planifikimi të jetë edhe më real, më i mirë sepse mund të behet dhe se, kjo na ndihmon në planifikime me solide, qoftë në shkurttime, qoftë në kursime...

Alim Rama, tha se, lista votuese ka qenë më e madhe statistiksisht krahasuar me zgjedhjet e kaluara, dhe se ajo nuk është krahasuar, por numrat, domethënë shifrat mund, dhe duhet të korrigohen...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratimin e këtij raporti ?

Miratohet rapporti unanimishtë, duke kërkuar që të merren parasysh edhe vërejtjet e dhëna nga anëtarët e KQZ-së.

3.Këshilli për Marrëdhëniet me Jashtë

Ftesa për KQZ-në për vëzhgimin e zgjedhjeve në Slloveni, 24 prill 2022:

Kreshnik Radoniqi: Shkurt, kemi marrë një ftesë për vëzhgimin e zgjedhjeve në Slloveni nga komisioni zgjedhor i këtij vendi. Jemi pajtuar në këshill që të shkoj një delegacion, por krahas vizitës studimore në Mal të Zi, të bëhet ndarje. Pra, të saktësohet se kush i vëzhgon zgjedhjet, dhe kush merr pjesë në vizitën studimore, pra të mos shkohet në dy vende nga ndonjëri nga ne...

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Kurteshi, Burim Ahmetaj, Arianit Elshani dhe Kreshnik Radoniqi.

Në fund, në parim, u vendos që vëzhgimi i zgjedhjeve në Slloveni të bëhet, mirëpo për numrin dhe se kush do të shkoj, do të vendoset në një takim tjetër...

5.Komiteti i Auditimit

Njoftim nga Komiteti i Auditimit:

Sami Kurteshi: Komiteti, bazuar në programin e ti, ka mbajtur mbledhjen e parë më 3 mars, dhe se kemi shqyrtuar një rend dite me 3 pika: Diskutimi dhe propozimi për miratim të planit të punës së Komitetit të Auditimit në KQZ për vitin 2022, Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së vitit 2021 i njësisë së Auditimit të Brendshëm, dhe Diskutimi dhe miratimi i raportit të Auditimit të Kontrollit të Brendshëm nga vitit 2021.

Plani i punës, do të sillet në KQZ kurse pikat tjera janë miratuar në komitet. Kurse ju informoj se, znj. Fatbardha Grabanica ka dhënë dorëheqje nga komiteti ynë, dhe atë për shkak të një pakënaqësie: domethënë rrëth një ofendimi që, ajo mendon se i është bërë... Ka qenë punë mospajtimesh, por jo fyterjesh dhe diçka ngjashëm...

Lidhur me këtë pikë, diskutoi edhe Ibrahim Selmanaj, Kreshnik Radoniqi që tha se duhet filluar procedura e plotësimit të anëtares së dorëhequr, dhe në fund Alim Rama, Sami Hamiti dhe Sami Kurteshi.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të panelit interviewues për pozitën zv. Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së dhe Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC-së.

7. **Të ndryshme.**

Për KQZ

Kryetari, z. Kreshnik Radoniqi
